



ERSI QAZOLLI

Nga ëndrrat kozmike te pasioni për bioteknologjinë

Që i vogël, Ersi kishte ëndrra të mëdha. Ideja për të udhëtuar në hapësirë, për të parë galaktikat nga afër dhe për të përjetuar nga brenda atë që shihte në ekran, e magjepste.

"Doja të bëhesha astronaut. Më dukej mahnitëse, interesante dhe e paimagjinueshme ideja për të udhëtuar në hapësirë për të zbuluar nëse ato që shihja në TV për hapësirën ishin të vërteta".



Një projekt nga Agjencia Zvicerane për
Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC

Në partneritet me:



Zbatuar nga:



HELVETAS



PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

Një ëndërr sa e bukur, aq edhe larg realitetit shqiptar. Gjatë procesit të këshillimit të karrierës, Ersi kuptoi se rruga drejt një karriere të tillë kërkonte një kombinim specifik aftësish dhe mundësish që nuk përputhej me vendin ku jetonte, as me rrethanat personale. Ishte ky momenti i parë i përplasjes mes ëndrrës dhe realitetit.

Por, pikërisht në atë proces, ndodhi diçka e papritur. "Gjatë këshillimit të karrierës zbulova një prirje për degën e bioteknologjisë ku dhe aktualisht studioj. Kur fillova të lexoj më shumë mbi fushën e bioteknologjisë, ndjeva një entuziazëm dhe një interes shumë të madh për këtë degë, të cilën nuk e kisha dëgjuar më parë dhe më bëri akoma më kurioz të pyes dhe të lexoja akoma më shumë", tregon Ersi.

"Në fillim të procesit të këshillimit ndihesha sikur të gjithë kishin një drejtim, e kishin gjetur se çfarë do bënin në jetën e tyre çfarë dege universitare do vazhdonin, ndërsa unë isha i paqartë, paksa i frikësuar. Por këshillimi i karrierës më ndihmoi ta kuptoj që kjo është krejt normale dhe pjesë e procesit të zgjedhjeve të ndryshme në jetë në këtë rast të profesionit tim në të ardhmen. Këshillimi më ndihmoi të kaloja këtë moment sikleti, frike se çfarë do të ndodhte me të ardhmen time", thotë Ersi.

Ndër profesionet që e habitën më shumë ishte pikërisht ai i bioteknologut. Një fushë që ndërthur teknologjinë me biologjinë dhe mjekësinë, duke sjellë një qasje inovative në zgjidhjen e problemeve të jetës reale. Ishte një zbulim që nuk do ta kishte bërë kurrë pa ndihmë profesionale dhe pa frymëzimin e duhur.

Ishte një ndjesi që nuk vinte nga jashtë, por nga brenda, një "po" e qartë dhe e sigurt për një rrugë që ndoshta nuk do ta kishte zbuluar kurrë pa ndihmën e këshillimit të karrierës.

Fillimi i këtij rrugëtimi nuk ishte i lehtë. Ersi pranon se ndjeu pasiguri dhe frikë. Të gjithë rreth tij i dukeshin të vendosur, ndërsa vet ndjente një zbrazëti – një mungesë drejtimi. Këshillimi i karrierës i tregoi se kjo pasiguri është më se normale. Nuk është një shenjë dobësie, por një pikënisje e shëndetshme drejt eksplorimit të vetes.

Ersi pranon se në një moment, ndjeu se shoqëria e shtynte drejt zgjedhjeve **"të sigurt"**, që ofrojnë stabilitet dhe të ardhura, por që shpesh kryhen pa pasion. Këshillimi e ndihmoi të dallojë se jo gjithçka që është **"e sigurt"** është edhe për të. Ai kuptoi se për të qenë i qetë me veten, duhej të ndiqte atë që e motivonte vërtet.

Sot, Ersi ndjehet i qartë për rrugën që ka zgjedhur. Ai ka krijuar një vizion për të ardhmen që nuk është diktuar nga të tjerët, por ndihmuar profesionalisht të dijë të zgjedh midis dëshirave, aftësitë dhe pasionet e tij.

Në fund të këtij udhëtimi, nëse do të kishte mundësi t'i fliste vetes së tij 14-vjeçar, Ersi do t'i thoshte të mos frikësohej nga paqartësia. T'i besonte vetes, të provonte gjëra të reja dhe të mos ndikohej nga zhurma e jashtme. Sepse rruga e duhur nuk është gjithmonë ajo që të tjerët e shohin për ty – por ajo që ti ndjen brenda vetes. **"Eksploro, provo gjëra të reja dhe dëgjo veten më shumë se të tjerët"**.

